




REPUBLIKA E KOSOVES / REPUBLIC OF KOSOVO Agjencia kundër Korrupsionit / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK	Nr. Bred. / Pr. Nr. 01-3846/12
Nr. i fto. / Broj stranice 02	Data / Datum 24-10-2012



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 10.10.2012, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllët rasti më nr.AKK-03-2628/12, për Zyrtarin e Lartë, z.Ruzhdi Morina - Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike "TRAINKOS Sh.A" për shkak se zyrtari i lartë publikë ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej, pasi që ka dëshmuar se ka dhënë dorëheqje nga funksioni i Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike "TRAINKOS Sh.A".

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të mundshëm të interesit është zhvilluar procedura e parapare sipas nenit 18.1 dhe 18.2 të Ligjit Nr.04/L-051, Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Pas informatës së marre, ka filluar shqyrtimi i lëndës me numër protokolli AKK-03-2628/12,që për trajtim ka pasur Zyrtarin e Lartë, z. Ruzhdi Morina - Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike "TRAINKOS Sh.A"

Gjatë zhvillimit të procedurës dhe analizimit të gjendjes është konstatuar se zyrtari i lartë, gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik si Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike "TRAINKOS Sh.A" ushtron edhe funksionin e Anëtarit të Bordit Udhëheqës në Trustin e Kursimeve pensionale të Kosovës, e që sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik Nr.04/L-051, kjo situatë ka paraqitur konflikt të mundshëm të

interesit, dhe mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik, andaj Agjencia kundër Korrupsionit me datën 06.08.2012, e ka njoftuar zyrtarin e Lartë me shkresën e parë se ka filluar procedura e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të Konfliktit të Interesit dhe se ka të drejte në afatin prej 15 ditësh të njoftohet me faktet që posedon Agjencia.

Pas këtyre procedurave z.Ruzhdi Morina, ka komunikuar me zyrtaret e Agjencisë dhe e ka konfirmuar se e ka marr shkresën njoftuese dhe dëshiron të njoftohet me detalisht për situatën që dyshohet për Konflikt të mundshëm të Interesit.

Pas kërkesës që ka bere zyrtari i lartë z.Ruzhdi Morina, për tu takuar dhe për tu informuar me detalisht me faktet që posedon Agjencia, zyrtari i AKK-se që është përgjegjës për rastin ka organizuar një takim dhe e ka njoftuar me faktet që posedon Agjencia.

Gjatë takimit z.Ruzhdi Morina është njoftuar se për cilën situatë bëhet fjale, ndërsa ai, është shprehur i gatshëm për bashkëpunim, por na ka njoftuar se për çështjen në fjale lidhur me ushtrimin e dy funksioneve Publike si Kryeshef Ekzekutiv i Ndërmarrjes Publike "TRAINKOS Sh.A" dhe funksionit si Anëtar i Bordit Udhëheqës të Trustit të Kursimeve pensionale ka vendosur që të jap dorëheqje nga funksioni i Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike "TRAINKOS Sh.A" pasi që edhe vetë e konsideron se munde të ketë elemente të Konfliktit të Interesit andaj me qëllim të shmangies eventuale të kësaj gjendje i ka paraqitur dorëheqjen Bordit të Drejtoreshave të TRAINKOS Sh.A . ku dhe na ka prezantuar kërkesën që i ka bërë Bordit udhëheqës të kësaj Kompanie.

Me datën 04.10.2012 .U.D i Sekretarit të Kompanisë "TRAINKOS Sh.A" z.Agim Kuleta e ka njoftuar Agjencinë kundër Korrupsionit se pas Dorëheqjes së Kryeshefit Ekzekutiv të NP TRAINKOS. Sh.A , Bordi i Drejtoreshave ka përmbyllur në tersi procedurat lidhur me Kryeshefin Ekzekutiv -TRAINKOS Sh.A, ku në mbledhjen e njëzet e një (21) të mbajtur me datën 27.09.2012 në bazë të kompetencave të veta ka përzgjedhur Kryeshefin e ri të Ndërmarrjes Publike "TRAINKOS Sh.A"

Andaj ne bazë të dëshmive dhe fakteve konstatojmë se :

Zyrtari i lartë, z.Ruzhdi Morina ka shmangur gjendjen e Konfliktit të Interesit në të cilën ndodhej pasi që ka dhënë dorëheqje nga pozita e Kryeshefit Ekzekutiv të " NP TRAINKOS Sh.A".

Kjo situatë ka paraqitur mos pajtueshmëri në ushtrimin e funksionit publik si, Kryeshef Ekzekutiv në NP TRAINKOS Sh.A. dhe si Anëtar i Bordit Udhëheqës të Trustit të Kursimeve pensionale.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

